



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. ref. 1/909
Datë: 9/7/2018

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", shpallë:

KONKURS

për pranimin e studentëve në vitin e parë të studimeve themelore- baçelor në vitin akademik 2018/2019

Senati i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" në bazë kompetencave të përcaktuara sipas nenit 106 të statutit në mbledhjen e mbajtur me 10.05.2018 ka miratuar propozimet e njësisë akademike për numrin e studentëve që do të pranohen në vitin akademik 2018/19, ndërsa në mbledhjen e datës 06.07.2018 ka miratuar kushtet dhe kriteret për regjistrim në studimet themelore – bachelor.

I. KUSHTET E PËRGJITHSHME

1. Universiteti i Prishtinës, në vitin e parë të studimeve, në afatin e parë të konkursit për vitin akademik **2018/2019**, do të regjistrojë **7066** studentë, prej të cilëve **6156** studentë të rregullt dhe **910** studentë me korrespondencë.
2. Mbi numrin e përgjithshëm të studentëve të paraparë si më sipër, Universiteti do të regjistrojë deri në **2%** përkatësisht deri në **142** studentë të rregullt që i takojnë familjes së ngushtë të dëshmorëve (anëtarë të familjes së ngushtë të dëshmorëve janë: bashkëshorti, bashkëshortja, fëmijët). Studentët e kësaj kategorie do të shpërndahen në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
3. Si shtesë e numrit të përgjithshëm të përcaktuar si në paragrafin 1, bazuar në UA nr. 09/2016 MASHT-it, Universiteti do të regjistrojë deri në **12 %**, përkatësisht deri **845** studentë të rregullt nga komuniteti jo-shumicë. Kuota prej **12%** të vendeve të rezervuara për regjistrim të studentëve nga komuniteti jo-shumicë do të shpërndahet në mënyrë proporcionale sipas përqindjes së numrit të përgjithshëm të studentëve për secilin departament apo program të fakulteteve veç e veç.
4. Në Universitet, në bazë të kuotave të përcaktuara nga MASHT-i, mund të pranohen deri në **3%** përkatësisht deri **216** kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvegja, dhe deri në **2%** përkatësisht deri **142** kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria. Kandidatët të cilët kanë lindur në vendet e sipërsënuara, ndërsa shkollimin e mesëm e kanë mbaruar në Republikën e Kosovës, do t'iu nënshtrohen kushteve të njëjta për pranim si kandidatët nga Kosova.
5. Përjashtimisht kushteve të veçanta të përcaktuara për kandidatët si në pikën 2, 3 dhe 4, nëse të njëjtit arrijnë të kualifikohen brenda numrit të paraparë si në pikën 1, atëherë këta kandidatë nuk do të llogariten në kuadër të kuotës së rezervuar.
6. Mbi bazë të konsideratave humane, Universiteti i Prishtinës rezervon të drejtën e pranimi të kandidatëve me nevoja të veçanta.
7. Universiteti nuk do të mundësojë lehtësira për pranim nëse njëri prej kandidatëve binjakë nuk arrin të pranohet në programin e njëjtë apo të ndryshëm me binjakun tjetër.
8. Të drejtë pranimi në Universitetin e Prishtinës kanë të gjithë kandidatët kosovarë, të cilët shkollimin e mesëm e kanë përfunduar në njërin prej shkollave publike apo shkollave private të licencuara në Republikën e Kosovës dhe që e kanë diplomën për shkollimin e kryer.
9. Në Universitet mund të pranohen edhe kandidatët nga shtetet e tjera në kushte të njëjta konkurrimi me kandidatët nga Kosova.
10. Kandidatë jo-kosovarë konsiderohen kandidatët të cilët shkollimin e mesëm e kanë mbaruar jashtë Kosovës.
11. Vendimi për njohjen dhe për barasvlerën diplomës merret nga MASHT, ndërsa barasvlera e notave do të bëhet nga zyra për zhvillim akademik e cila gjendet në Fakultetin Filozofik, kati II nr.107.

12. Universiteti do të sigurojë përgatitjen e testeve për provim pranues në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin paraprak ose/dhe për të cilën deklarohen paraprakisht në formularin për vetë deklaram, përveç në rastet specifike ku testi do të përgatitet në gjuhën në të cilën zhvillohet programi (psh. në programet e Fakultetit të Filologjisë).
13. Njësitë akademike përkatëse me rastin e aplikimit të kandidatëve nga komuniteti jo-shumicë bëjnë verifikimin e dokumentacionit pedagogjik duke përfshirë dëftesat dhe diplomat në gjuhën në të cilën kandidatët kanë përfunduar shkollimin e mesëm.
14. Deklarimi i rrejshëm në formularin për vetë deklaram, sipas nenit 391 të Kodit Penal (KODI NR. 04/L-082) të Republikës së Kosovës konsiderohet vepër penale.
15. Kandidatët të cilët kanë të regjistruar një program studimi në cilindo nivel të studimit në kuadër të Universitetit të Prishtinës nuk kanë të drejtë konkurrimi në program tjetër studimi në UP pa përfunduar studimet në programin ku kanë qenë duke studiuar ose pa u çregjistruar nga programi aktual i studimeve.
16. Kandidatët për pranim si student të UP-së në vitin akademik 2018/19 nuk mund të konkurrojnë më shumë se në një fakultet, departament, drejtim apo program.

II. MËNYRA E PËRZGJEDHJES SË KANDIDATËVE

1. Përzgjedhja e kandidatëve për të gjitha fakultetet do të bëhet sipas kritereve si në vijim:
 - a) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme e nuk kanë pasur provim të maturës: Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë; dhe
 - Suksesi në provim pranues deri në 70 pikë.
 - b) Për nxënësit që kanë diplomë për kryerjen e shkollës së mesme dhe e kanë dhënë me sukses provimin e maturës: Numri maksimal i pikëve sipas kritereve vijuese është 100 pikë, dhe atë:
 - Suksesi në shkollën e mesme deri në 30 pikë;
 - Suksesi në maturë deri në 30 pikë; dhe
 - Suksesi në provimin pranues deri në 40 pikë.
2. Të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm kandidatët që arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
3. Kandidatët të cilët nuk arrijnë së paku 40% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues nuk mund të pranohen edhe nëse mbeten vende të paplotësuara sipas konkursit.
4. Përgjithësisht kushteve të përgjithshme të përcaktuara në paragrafin 2 dhe 3 të pikës III, kandidatët të cilët konkurrojnë sipas kritereve të përcaktuara si në paragrafin 2, 3 dhe 4 të pikës I, të drejtë radhitjeje, përkatësisht pranimi kanë vetëm ata që arrijnë së paku 30% nga numri i pikëve të parapara për provim pranues.
5. Fakultetet e organizojnë mbajtjen e provimit pranues në lëndët mësimore të cilat i caktojnë vetë fakultetet.
6. Fakultetet me specifika të veçanta organizojnë provim praktik në lëndë dhe disiplina përkatëse.
7. Fakultetet janë të obliguara që listën e kandidatëve që kanë konkurruar, t'ia dërgojnë Rektoratit të Universitetit dhe ta publikojnë në ueb-faqen e Fakultetit.
8. Për funksionimin e departamentit, seksionit, degës, drejtimit ose programit të fakultetit është i nevojshëm numri minimal prej 20 studentëve, përveç Fakultetit të Arteve, ku grupi mund të formohet edhe me më pak studentë.
9. Nëse numri i pikëve të disa kandidatë të ranguar si të fundit në listën e të pranuarve është i barabartë me kandidatë tjerë jashtë numrit të planifikuar për pranim, zgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të suksesit të provimit pranues, e nëse edhe pikët e provimit pranues janë të njëjta atëherë do të merret parasysh suksesi i shkollës mesme. Në qoftes se edhe suksesi është i njëjtë atëherë përparësi do të kenë kandidatet e gjinisë femërore.

III. AFATET E KONKURSIT

Për regjistrimin e studentëve në vitin e parë të studimeve, oraret do të jenë si në vijim:

1. Paraqitja e dokumenteve zgjatë prej datës **9.7.2018** deri më **17.7.2018** në ora 16.00 (dokumentet do të pranohen çdo ditë me përjashtim të dielave).
2. Ditën e parë të konkursit, me datë **9.7.2018**, aplikimi online do të funksionalizohet nga ora **9.00**, ndërsa pranimi i dokumentacionit në njësitë akademike do të fillojë nga ora **10.00**.
3. **Kandidatëve u rekomandohet që para paraqitjes në konkurs të bëjnë kopje të mjaftueshme të dokumenteve, sepse dokumentet origjinale nuk do të mund t'i tërheqin deri në diplomim apo çregjistrim nga fakulteti.**
4. **Me rastin e paraqitjes, kandidatët duhet t'i sjellin këto dokumente:**
 - a) *Ekstraktin e lindjes (origjinal) jo me i vjetër se 6 muaj,*
 - b) *Dëftesat e të gjitha klasave të shkollës së mesme (origjinal, të noterizuara ose dublikatë),*
 - c) *Diplomën e kryerjes së shkollës së mesme ose dëftesën e maturës, nëse ka pasur provim të maturës (origjinal, të noterizuar ose dublikatë-Dublikati),*
 - d) *Kopjen e letërnjoftimit,*
 - e) *Fletëparaqitja e plotësuar shkarkohet gjatë aplikimit online nga interneti: Vegza (Linku) për konkurrim online përmes Internetit është: <http://apliko.uni-pr.edu>*
 - f) *Pagesën prej 2.5 Euro. Forma e pagesës shkarkohet dhe shtypet nga ueb-faqja e Universitetit të Prishtinës, ndërsa pagesa bëhet në bankë,*
 - g) *Vendimin mbi njohjen e shkollimit jashtë vendit.*
5. **Me rastin e aplikimit, të gjithë kandidatët janë të obliguar që dokumentet e nevojshme si në pikën 3 të këtij neni t'i dorëzojnë në sportelet e fakulteteve në dosje (fasikull) të bardhë e cila duhet të jetë unike për të gjithë kandidatët.**
6. Dokumentet nën pikën b) dhe c) mund të pranohen dublikatë vetëm nëse dëshmohen me vërtetim të organeve kompetente për humbje, dëmtim, vjedhje etj. ***P.S. Pas nxjerrjes së dokumenteve dublikatë, dokumentet origjinale nuk mund të shfrytëzohen nga kandidati pasi që ky veprim konsiderohet veprë penale.***
7. Njoftimet dhe oraret për vendin ku do të mbahen provimet pranuese mund të merren në fakultetet përkatëse, si dhe në ueb-faqet e këtyre fakulteteve. Datat e mbajtjes së provimeve pranuese në fakultetet e ndryshme janë të shpallura në vijim:

Provimi pranues do të mbahet më datë 19-21.7.2018, sipas orarit si në vijim:

1. Fakulteti Filozofik më datë 19.7.2018 në ora 9.00
 2. Fakulteti i Filologjisë më datë 20.7.2018 në ora 9.00
 3. Fakulteti Juridik më datë 19.7.2018 në ora 9.00
 4. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës më datë 19.7.2018 fillon në ora 9.00-15.00
 5. Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike më datë 19.7.2018 fillon në ora 15.30-17.30
 6. Fakulteti i Arteve të Bukura më datë 19.7.2018 dhe 20.7.2018 në ora 9.00
 7. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinës më datë 19.7.2018 në ora 9.00
 8. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike më datë 20.7.2018 fillon në ora 9.00-11.00
 9. Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit më datë 19 dhe 20.7.2018 në ora 8.00
 10. Fakulteti i Edukimit më datë 20.7.2018 në ora 9.00
 11. Fakulteti i SHMN-së më datë 19.7.2018 në ora 9.00
 12. Fakulteti Ekonomik më datë 20.7.2018 në ora 9.00
 13. Fakulteti i Mjekësisë më datë 21.7.2018 duke filluar nga ora 9.00.
8. **Të gjithë kandidatët në provim pranues duhet ta posedojnë letërnjoftimin, pa të cilën nuk mund t'i nënshtrohen provimit pranues. Në kohën e mbajtjes së provimit pranues ndalohet përdorimi i telefonave celularë!**

IV. SHPALLJA E REZULTATEVE PRELEMINARE DHE PËRFUNDIMTARE

1. Shpallja e rezultateve preleminare e provimit pranues do të bëhet më së voni deri më **22.7.2018** në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse.
2. Shpallja e rezultateve përfundimtare të provimit pranues do të bëhet më së voni deri më **26.7.2018** në tabelat e shpalljeve si dhe në ueb-faqen e fakulteteve përkatëse.

V. E DREJTA DHE AFATI PËR ANKESË

1. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar mund t'i paraqesin ankesë fakultetit përkatës **më së largu 48 orë pas publikimit të rezultateve preleminare** (llogariten ditët e punës). Pas këtij afati, ankesat nuk do të pranohen. Shqyrtimi i ankesave bëhet vetëm nga Komisioni për shqyrtimin e ankesave nga fakulteti përkatës.
2. Kandidatët të cilët nuk janë pranuar, mund t'i tërheqin dokumentet e tyre në fakultetin përkatës me datë **27.7.2018 dhe me datë 29 e 30 gusht 2018.**
3. **Në departamentet, degët, drejtimet ose programet ku nuk plotësohet numri i kandidatëve të paraparë me këtë konkurs, do të shpallet konkurs plotësues.**
4. Për informata më të hollësishme, kandidatët mund t'u drejtohen fakulteteve përkatëse ose ta vizitojnë faqen e internetit: www.uni-pr.edu

VI. AFATET E REGJISTRIMIT PËR KANDIDATËT E PRANUAR

1. **Regjistrimi dhe fotografimi i kandidatëve të pranuar do të bëhet në Administratën Qendrore të UP-së (ndërtesa e Bibliotekës Universitare), sipas këtij orari:**
 - Fakulteti Filozofik më datë **3.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Shkencave Matematiko-Natyrore më datë **4.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Filologjisë më datë **5.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti Juridik më datë **6 dhe 7.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti Ekonomik:
 - më **10.9.2018 (FBK)** prej orës **9:00 -15.00**
 - më **11.9.2018 (MXH)** prej orës **9:00 -15.00** dhe
 - më **12.9.2018 Marketing, Ekonomiks dhe Kontabilitet),** prej orës **9:00 -15.00**;
 - Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës më datë **13.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Arteve të Bukura më datë **13.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike më datë **14.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike më datë **17.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit më **18.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Mjekësisë më datë **18.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë më datë **19.9.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
 - Fakulteti i Edukimit më datë **19.2018** prej orës **9:00 - 15:00**;
2. **Kandidatët të cilët nuk kanë arritur që të regjistrohen brenda afateve të përcaktuara si më sipër, mund të regjistrohen më së voni deri më **30.9.2018**. Jashtë këtij afati kandidatët e pranuar nuk do të mund të regjistrohen, prandaj luten që t'i përmbahen afatit të lartshënuar.**
3. Procesi i regjistrimit të një kandidati të pranuar konsiderohet i përmbyllur në momentin e fotografimit.
4. Në qoftëse kandidati i pranuar, në afatin e caktuar nuk i përfillë të gjitha procedurat e parapara në këtë konkurs, konsiderohet se ai/ajo ka hequr dorë nga e drejta e regjistrimit.
5. Kandidatët e pranuar për regjistrim duhet të paraqesin:
 - a) Fletëregjistrimin e plotësuar, i cili shkarkohet dhe shtypet (bardh e zi) nga faqja <http://apliko.uni-pr.edu>
 - b) Dy fotografi (formati 4.5 x 6 cm), të cilat duhet të jenë sipas normave dhe rregullave për dokumente personale.
 - c) Studentët shtetas të Republikës së Kosovës që fillojnë studimet në Universitetin e Prishtinës, vitin e parë të studimeve e kanë falas.
 - d) Pagesa për një semestër për studentë që nuk janë shtetas të Republikës së Kosovës, do të jetë në lartësi prej **25 €** për studime të rregullta, respektivisht **125 €** për studime me korrespondencë.
6. Pagesa bëhet në njërën prej bankave afariste me fletëparaqitje për pagesë, e cila shkarkohet dhe shtypet nga Ueb faqja Universitetit të Prishtinës.

I. FAKULTETI FILOZOFIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **727** studentë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Per studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
Filozofik	610	0	13	72	19	13	727
Departamenti Filozofi	100	0	2	12	2	2	118
Programi Filozofi	100	0	2	12	2	2	118
Departamenti Punë Sociale	50	0	1	6	2	1	60
Programi Punë Sociale	50	0	1	6	2	1	60
Departamenti Histori	120	0	3	14	4	2	143
Programi Histori	120	0	3	14	4	2	143
Departamenti Shkenca Politike	100	0	2	12	3	2	119
Programi Shkenca Politike	100	0	2	12	3	2	119
Departamenti Sociologji	100	0	2	12	3	2	119
Programi Sociologji	100	0	2	12	3	2	119
Departamenti Psikologji	100	0	2	12	3	2	119
Programi Psikologji	100	0	2	12	3	2	119
Departamenti i Antropologjisë	40	0	1	4	2	2	49
Profili Antropologji Kulturore	20	0	1	2	1	1	25
Profili Arkeologji	20	0	0	2	1	1	24

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e lëmit të ngushtë profesional të degëve mësimore të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Filozofisë nga Filozofia dhe Sociologjia;
- Në Departamentin e Punës sociale nga Edukata qytetare, Psikologji dhe Sociologjia .
- Në Departamentin e Historisë nga Historia e botës, Historia e popullit shqiptar dhe Edukatë qytetare
- Në Departamentin e Shkencave Politike nga Sociologjia, Filozofia, Historia dhe Edukata qytetare.
- Në Departamentin e Sociologjisë nga Sociologjia dhe Filozofia.
- Në Departamentin e Antropologjisë nga Historia, Letërsia dhe Sociologjia.
- Në Departamentin e Psikologjisë nga Psikologjia, Filozofia dhe Verifikimi i aftësive të përgjithshme për studime.

II. FAKULTETI I SHKENCAVE MATEMATIKE-NATYRORE - PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **666** studentë të rregullt, dhe atë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
SHMN	560	0	11	67	16	12	666
Departamenti i Matematikës	150	0	3	18	5	3	179
Programi Matematikë,	60	0	1	7	2	1	71
Programi Shkencat Kompjuterike	60	0	1	7	2	1	71

Programi Matematikë financiare në banka dhe sigurime	30	0	1	4	1	1	37
Departamenti i Fizikës	80	0	2	10	2	2	96
Programi Fizikë	80	0	2	10	2	2	96
Departamenti i Kimisë	135	0	2	16	4	3	160
Programi Kimi	75	0	1	9	2	2	89
Programi Kimi Inxhinierike	60	0	1	7	2	1	71
Departamenti i Biologjisë	120	0	3	14	3	2	142
Programi Biologji	75	0	2	9	2	1	89
Programi Ekologji-Mbrojtje e mjedisit	45	0	1	5	1	1	53
Departamenti i Gjeografisë	75	0	1	9	2	2	89
Programi Gjeografi	75	0	1	9	2	2	89

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e mëmit të ngushtë profesional të departamentit përkatës të fakultetit dhe atë:

- Në Departamentin e Matematikës nga Matematika;
- Në Departamentin e Fizikës nga Fizika dhe Matematika ;
- Në Departamentin e Kimisë nga Kimia, Fizika dhe Matematika;
- Në Departamentin e Biologjisë nga Biologjia dhe Kimia;
- Në Departamentin e Gjeografisë nga Gjeografia,

Në testet e provimit pranues të cilat kanë detyra krahas qarkimit të përgjigjes së saktë duhet të ofrohet edhe zgjidhja e detyrës.

III. FAKULTETI I FILOLOGJISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **686** studentë në departamentet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
Filologjik	565	10	12	70	17	12	686
Programi Gjuhë Shqipe	60	0	1	7	2	1	71
Programi Letërsi Shqipe	80	0	2	10	2	2	96
Programi Gjuhë dhe Letërsi Angleze	110	0	2	13	3	2	130
Programi Gjuhë dhe Letërsi Gjermane	120	0	2	14	4	2	142
Programi Gjuhë dhe Letërsi Frënge	50	0	1	6	2	1	60
Programi Orientalistikë	30	0	1	4	1	1	37
Programi Gjuhë dhe Letërsi Turke	35	10	1	5	1	1	53
Programi Gazetari	80	0	2	11	2	2	97

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët e fushës së ngushtë profesionale të degës përkatëse të fakultetit dhe atë:

- Në Programin e Gjuhës Shqipe nga gjuha shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Letërsisë Shqipe nga letërsia shqipe (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Angleze nga gjuha angleze (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Gjermane nga gjuha gjermane (me shkrim);
- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Frënge nga gjuha frënge (me gojë);
- Në Programin e Orientalistikës nga gjuha arabe dhe gjuha turke (me gojë);

- Në Programin e Gjuhës dhe Letërsisë Turke nga gjuha turke (me shkrim);
- Në Programin e Gazetarisë provimi pranues mbahet në formë testi nga lëmit: gjuhë shqipe, letërsi shqipe, qytetërim shqiptar, qytetërim botëror dhe Ese.

IV. FAKULTETI JURIDIK

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë 952 studentë, prej të cilëve 702 të rregullt dhe 250 me korrespondencë .

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
Juridik	550	250	16	96	24	16	952

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lëndët: Fillet e së drejtës, E drejta kushtetuese dhe Gjuhë shqipe.

V. FAKULTETI EKONOMIK-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë 1963 studentë prej të cilëve 1313 studentë të rregullt, 650 me korrespondencë, dhe atë si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
Ekonomik	1000	650	33	198	50	32	1963
Departamenti Banka, financa dhe kontabilitet	300	250	11	66	15	10	652
Programi Banka, financa dhe kontabilitet	300	250	11	66	15	10	652
Departamenti Menaxhment dhe Informatikë	230	200	9	52	13	9	513
Programi Menaxhment dhe Informatikë	230	200	9	52	13	9	513
Departamenti Marketing	150	100	5	30	8	5	298
Programi Marketing	150	100	5	30	8	5	298
Departamenti Ekonomiks	150	100	5	30	8	5	298
Programi Ekonomiks	150	100	5	30	8	5	298
Departamenti i Kontabilitetit	120	0	2	14	4	2	142
Programi i Kontabilitetit	120	0	2	14	4	2	142
Departamenti Ekonomi e aplikuar dhe menaxhment	50	0	1	6	2	1	60
Programi Ekonomi e aplikuar dhe Menaxhment ne gjuhen angleze)	50	0	1	6	2	1	60

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për departamentet në gjuhën shqipe do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi dhe Matematikë. Provimi pranues në Programin Ekonomi e aplikuar dhe Menaxhment (në gjuhën angleze), do të mbahet nga lëndët: Hyrje në ekonomi, Matematikë dhe Gjuhë angleze.

VI. FAKULTETI I NDËRTIMTARISË DHE ARKITEKTURËS-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **451** studentë të rregullt dhe atë sipas departamenteve si në vijim :

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
FNA	380	0	7	45	12	7	451
Departamenti i Konstruksioneve	120	0	2	14	4	2	142
Programi Konstruktiv	120	0	2	14	4	2	142
Departamenti i Hidroteknikës	60	0	1	7	2	1	71
Programi Hidroteknikë	60	0	1	7	2	1	71
Departamenti i Inxhinierisë së Ambientit	40	0	1	5	1	1	48
Programi Inxhinieri e Ambientit	40	0	1	5	1	1	48
Departamenti i Gjeodezisë	60	0	1	7	2	1	71
Programi Gjeodezi	60	0	1	7	2	1	71
Departamenti i Arkitekturës	100	0	2	12	3	2	119
Programi Arkitekturë	100	0	2	12	3	2	119

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga Matematika, ndërsa në Departamentin e Arkitekturës edhe nga Perceptimi i hapësirës dhe Vizatimi i lirë (sllajdi).

Për tu ranguar kandidati duhet të arrijë minimum 40% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues, përveç kandidatëve që i takojnë kategorisë si në paragrafin 2, 3 dhe 4 të pikës I të këtij konkursi të cilët duhet të arrijë minimum 30% nga pikët e parapara për secilën pjesë të provimit pranues.

VII. FAKULTETI I INXHINIERISË ELEKTRIKE DHE KOMPJUTERIKE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **546** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
FIEK	460	0	9	55	13	9	546
Programi Inxhinierisë Kompjuterike	160	0	3	19	4	3	189
Programi Telekomunikacion	80	0	2	10	2	2	96
Programi Elektronikë	60	0	1	7	2	1	71
Programi Automatikë e Kompjuterizuar dhe Robotikë	60	0	1	7	2	1	71
Programi Elektroenergjetikë	100	0	2	12	3	2	119

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues do të mbahet nga lënda: Matematikë.

VIII. FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë 648 studentë të rregullt dhe atë sipas programeve si në vijim :

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Per studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
FIM	540	0	12	66	18	12	648
Programi Prodhimtari dhe Automatizim	90	0	2	11	3	2	108
Programi Termoenergjetika dhe Energjia e Ripërtëritshme	90	0	2	11	3	2	108
Programi Komunikacion dhe transport	90	0	2	11	3	2	108
Programi Inxhinieria Industriale dhe Menaxhmenti	90	0	2	11	3	2	108
Programi Mekatronikë	90	0	2	11	3	2	108
Programi Konstruksiione dhe Mekanizim	90	0	2	11	3	2	108

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues mbahet nga lënda Matematikë.

IX. FAKULTETI I MJEKËSISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë 441 studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
Mjekësisë	370	0	7	44	13	7	441
Programi Mjekësi e Përgjithshme	150	0	3	18	5	3	179
Programi Stomatologji	70	0	1	8	2	1	82
Programi Farmaci	50	0	1	6	2	1	60
Programi Fizioterapi	50	0	1	6	2	1	60
Programi Infermieri	50	0	1	6	2	1	60

Kandidatët të cilët aplikojnë për programet e studimit: Fizioterapi dhe Infermieri duhet të kenë të kryer shkollën e mesme të Mjekësisë.

PROVIMI PRANUES

Provimi pranues për të gjitha degët e Fakultetit të Mjekësisë mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji.

X. FAKULTETI I ARTEVE TË BUKURA-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë 203 studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Per studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
Arteve të Bukura	171	0	3	20	6	3	203
Departamenti i Arteve të Bukura	62	0	1	6	3	1	73
Programi Bachelor i Arteve Vizuele	50	0	1	5	2	1	59
Specializimi Pikturë	16	0	1	2			19
Specializimi Skulpturë	8	0	0	1			9
Specializimi Grafikë	14	0	0	1			15
Specializimi Arti konceptual dhe mediet e reja	12	0	0	1			13
Programi Bachelor i Arteve aplikative	12	0	0	1	1	0	14
Specializimi Dizajn Grafik	12	0	0	1			13
Departamenti i Artit Muzikor	72	0	1	9	2	1	85
Programi Bachelor i Muzikës	27	0	1	3	1	1	33
Profili Pedagogji e përgjithshme muzikore	25	0	1	3			29
Profili Kompozim	2	0	0	0			2
Programi Bachelor i Muzikës në Performim	45	0	0	6	1	0	52
Profili Solo këndim	4	0	0	1			5
Profili Dirigjim	2	0	0	0			2
Profili Piano	10	0	0	1			11
Profili Harkor	18	0	0	2			20
Violinë	5	0	0	0			5
Violë	5	0	0	0			5
Violonçelo	2	0	0	0			2
Kontrabas	2	0	0	0			2
Kitarë	4	0	0	0			4
Profili Frymor	11	0	0	2			13
Flaut	4	0	0	0			4
Oboa	1	0	0	0			1
Klarinetë	4	0	0	0			4
Trombon	2	0	0	0			2
Departamenti i Artit Dramatik	37	0	1	5	1	1	45
Programi Aktrim	12	0	1	1			14
Programi Dramaturgj	6	0	0	1			7
Programi Regji filmi dhe televizioni	6	0	0	1			7
Programi Regji teatri	6	0	0	1			7
Programi Dizajn skene dhe kostumografi	7	0	0	1			8

KUSHTET E REGJISTRIMIT

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në Fakultetin e Arteve duhet t' i plotësojnë edhe këto kushte:

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE TË BUKURA

Për përcaktimin e talentit për krijimtari artistike, kushtet e veçanta për studim në Degën e Arteve të Bukura janë:

Programi Bachelor i Arteve vizuale

Specializimi Pikturë

- Portfolio me 5 punime të punuara sipas modelit (studimi i kokës dhe figura në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj).

Specializimi Skulpturë

- Portfolio me 5 punime nga skulptura sipas modelit, prej të cilave një duhet të jetë studimi i kokës në përpjesëtime natyrore dhe së paku 5 vizatime sipas modelit.

Specializimi Grafikë

- Portfolio me punime sipas modelit (studimi i kokës dhe figurës në përpjesëtime natyrore) dhe së paku 5 punime sipas zgjedhjes së lirë (natyrë e qetë, peizazh, kompozicion etj.).

Specializimi Arti Konceptual dhe Mediet e Reja

Faza e parë

- kandidatët i nënshtrohen testit të përbërë prej 10 pyetjeve nga mediumet e reja në artet bashkëkohore.
- kandidatët shkruajnë një ese prej 400 fjalë.

Faza e dytë

Puna praktike në mediumin që e zgjedh vetë kandidati.

1. Pikturë konceptuale;
2. Video instalacion;
3. Video;
4. Skulpturë konceptuale, instalacion etj.

Faza e tretë

Portofolion me 10 punime nga mediumet e reja, Pikturë konceptuale, Video instalacion, Video, Skulpturë konceptuale, instalacion etj.

Kandidatët do të kenë intervistë lidhur me njohuritë mbi profesionin që do të studiojnë.

Programi Bachelor i Arteve aplikative

Specializimi Dizajnit Grafik

1. Portofolion me punimet e realizuar: 10 punime nga fusha e dizajnit, vizatime, ilustrime, poster, logo, ambalazh produkti, 3D realizime, realizime bukurshkrimi, fotografi artistike.....
2. Provimi pranues 2 ditor sipas metodave vlerësuese:

Dita e parë e provimit pranues:

- a) Seanca 1-ilustrimi i një teme sipas përshkrimit tekstual: 3 orë;
- b) Seanca 2-vizatimi perceptues sipas motivit (vendosja kompozicionale, perspektiva...): 3 orë;

Dita e dytë e provimit pranues:

- c) Seanca 3- Vlerësimi praktik i programeve grafike (dizajnim i zgjedhur logo, afishe.....): 3 orë, (30 min për student)
- d) Seanca 4- Intervista me kandidatet (vlerësimi i portfolios...), 3 orë.

NË DEPARTAMENTIN E ARTEVE MUZIKORE

Përveç kushteve të përbashkëta të përcaktuara me konkurs, kandidatët e paraqitur në konkurs për regjistrim në nivelin bachelor në Fakultetin e Arteve respektivisht në profilet e Departamentit të Muzikës duhet t'i plotësojnë edhe këto kushte:

-Duhet të ketë të përfunduar shkollën e mesme të Muzikës në instrumentin përkatës apo drejtimin përkatës.

Profili: PIANO

- Provim nga lënda PIANO - (a)J. S. Bach - 1 Prelud dhe Fugë nga ËTC b)1 Vepër virtuoze; c) 1 Sonatë klasike (një kohë); d)1 Vepër madhore romantike;
- Provim nga lënda: SOLFEZH;

- Provim nga lënda TEORI E MUZIKËS;

Profili: INSTRUMENTET ME HAROE DHE KITARA

- Provim nga instrumenti harkor përkatës- (a) J. S. Bach - 1 Kohë nga Suita / Partita; b) 1 Koncert (një kohë); c) 1 Sonatë (një kohë); d) 1 Pjesë cantilene;
- KITARA- a) 2 kohë nga suitat e Bach-ut (nga suitat për çello ose flaut); b) F. SOR – 1 etidë nga op.6.dhe 29; c) 1 etidë përzgjedhje; d) 1 vepër ciklike:
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

Profili: INSTRUMENTET FRYMORE

- Provim nga lënda e instrumenti frymor përkatës- (a) 1 Koncert (komplet); b) 1 Sonatë (komplet); c) 1 Pjesë virtuoze;)
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: TEORI e MUZIKËS

Profili SOLO KËNDIM

- Provim nga lënda: SOLO KËNDIM -(a) 2 Arie (nga repertori operistik);b) 2 Këngë solo (në cilëndo gjuhë);
- Provim nga lëndët: SOLFEZH - TEORI e MUZIKËS
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

Profili: DIRIGJIM

- Dirigjim i veprës orkestrale apo korale; (dirigjim public ose DVD)
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: HARMONI
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

BACHELOR I MUZIKËS

Profili: KOMPOZIM

- Prezentimi i 3 kompozimeve të dorëzuara;
- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lëndët: HARMONI - POLIFONI
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

Profili: PEDAGOGJI E PËRGJITHSHME E MUZIKËS

- Provim nga lënda: SOLFEZH
- Provim nga lënda: HARMONI
- Provim nga lënda: PIANO OBLIGAT

NË DEPARTAMENTIT E ARTEVE DRAMATIKE

Për verifikimin e aftësive të veçanta, kandidatët do të japin këto provime:

Programi Aktrim

Pjesa e parë e programi eliminues:

- Recitim i një poezie (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Monolog dramaturgjia e autorëve- dramaturgëve botëror dhe kombëtar (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Tregim i shkurtër popullor (sipas zgjedhjes së kandidatit);
- Një këngë;
- Një imitim;

Kandidati është i obliguar që t'i mësojë përmendësh dhe t'i përgatisë detyrat. Komisioni, pas programit të shfaqur, mund t'i shtrojë kandidatit edhe detyra plotësuese (improvizime), për të fituar bindje sa më të plotë për aftësitë e kandidatit.

Pjesa e dytë e programit eliminues:

- puna me mësimdhënës të caktuar,
- verifikimi përfundimtar i aftësive.
- Të gjithë aplikantët luten të sjellin fotografi “bust” në ditën e aplikimit.

Programi Regji Teatri

Kandidatët duhet të sjellin një koncept regjisorial për inskenimin e një shfaqje, me skica për hapësirë skenike. Provimin pranues zhvillohet në dy pjesë:

Pjesa e parë e provimit përbëhet nga vlerësimi i punimeve të sjella dhe vlerësimi i kulturës së përgjithshme të kandidatit, ndërsa pjesa e dytë e provimit pranues (për kandidatët të cilët e kalojnë pjesën e parë të provimit) përbëhet nga inskenimi i një situatë nga një situatë nga një dramë e përcaktuar nga komisioni vlerësues.

Programi i Regji Filmi dhe Televizioni

Kandidatët që konkurrojnë në Regji Filmi duhet t'i nënshtrohen testit me pyetje të kulturës së përgjithshme, në veçanti nga arti dhe kryesisht nga filmi.

Sinopsis me shkrim në temën e dhënë në pjesën e parë të provimit. Tema jepet menjëherë pas testit në provim.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e dytë, i mbrojnë para komisionit punimet e veta.

Kandidatët, që e kalojnë në pjesën e tretë, janë të detyruar të gjirojnë vetë në temën e dhënë (film tre minutash), të cilin e shfaqin para komisionit në finale.

Programi Dramaturgj

Hartim me shkrim në temën e lirë,

Dialogu me shkrim në temën e tragjedisë,

Dialogu me shkrim në temën e komedisë,

Testimi me gojë lidhur me njohuritë nga sfera e kulturës së përgjithshme,

Testim me gojë nga fusha e dramaturgjisë.

Programi Dizajn skene dhe Kostumografi

- Portfolio me 10 projekte ideore (skenografi): skica të skenografisë për dramë të caktuar, një skenografi të inskenuar në hapësirë të caktuar.

Kandidatët i nënshtrohen provimit pranues si vijon:

- Në Programin Dizajn skene: portret sipas modelit (1 ditë), vizatim i aktit (1 ditë) dhe detyrë nga piktura në skenografi (1 ditë).

- kandidatët i nënshtrohen testit nga regjia e filmit, TV dhe teatrit.

Literatura për provim pranues: Aktrim, Regji Teatri, Regji Filmi dhe Dramaturgj

1. Georg Sodull - "Historia e filmit"
2. Abaz Hoxha - "Historia e filmit shqiptar"
3. Luis Herman - Skenari i filmit dhe i televizionit
4. Jezhi Plazhevski - Gjuha e filmit
5. Fadil Hysaj: "Teatrollogji, dramaturgj, regji dhe aktrim"
6. Aristoteli: "Poetika"
7. Vlladan Shvacov: "Bazat e dramaturgjisë"
8. Dr. Nebi Islami: "Historia e dramës kombëtare 1886-1996"
9. Dr. Josif Papagjoni: "Komedi që vjen nga skena"
10. Eskili: "Orestia"
11. Sofokli: Një tragjedi
12. Aristofani: Një komedi
13. Shekspiri: Një tragjedi
14. Moliери: Një komedi
15. Dramaturgj nga tradita: Anton Santori, Sami Frashëri, Kristo Floqi etj.
16. Dramaturgj bashkëkohore: Anton Pashku, Haqif Mulliqi, Rexhep Qosja, Ymer Shkreli, Flamur Hadri, Ekrem Kryeziu, Nebih Islami, Kasem Terbeshina etj.

XI. FAKULTETI I BUJQËSISË DHE VETERINARISË-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë 630 studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
Bujqësisë dhe Veterinarisë	530	0	11	64	14	11	630
Programi Prodhimtaria bimore	140		3	17	3	3	166
Programi Menaxhimi i biznesit në zootekni	80		2	10	2	2	96

Programi Mjekësi Veterinare	70	1	8	2	1	82
Programi Ekonomia Bujqësore	140	3	17	4	3	167
Programi Teknologji ushqimore me bioteknologji	100	2	12	3	2	119

PROVIMI PRANUES

Në programin Mjekësi Veterinare, provimi pranues mbahet nga lëndët: Kimi dhe Biologji, ndërsa për programet tjera, provimi mbahet në lëndët: Kimi, Biologji dhe Matematikë.

XII. FAKULTETI I EDUKIMIT FIZIK DHE I SPORTIT-PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **179** studentë të rregullt (**119** meshkuj dhe **60** femra)

Fakulteti-Departamenti-Programi	Për studime të rregullta	Për studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
Edukimi Fizik dhe i Sportit	150	0	3	18	5	3	179
Meshkuj	100	0	2	12	3	2	119
Femra	50	0	1	6	2	1	60

Kandidatët, para se të aplikojnë, duhet të sjellin dëshmi për kontroll të Gjendjes Psiko-Somatike (gjendja shëndetësore, të folurit, të shikuarit, të dëgjuarit, konstruksioni trupor).

Kontrolli mjekësor bëhet në Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive, në Pallatin e Rinisë dhe Sporteve.

PROVIMI PRANUES

Përmbajtja dhe mënyra e dhënies së provimit pranues është:

- Njohuritë lëvizore (motorike) sportive:
 - Futboll: puna me top-këmbë dhe kokë.
 - Hendboll: pasimet, trehapëshi dhe goditja në portë.
 - Basketboll: pasimi me dy duar, driblimi i topit me një dorë, dyhapëshi dhe gjuajtja në kosh.
 - Volejbol: pasimi i topit në çifte me gishtërinj dhe llëra (çekan), gjuajtja dhe pranimi i topit.
- Aftësitë lëvizore (motorike):
 - Kërcimi nga vendi në gjatësi,
 - Ngritja me forcë në hekur (meshkujt),
 - Përkulje mbi krah (femrat),
 - Shpejtësia në 100 m (matet koha e vrapimit- meshkujt dhe femrat),
 - Bashkërendimi (koordinimi lëvizor),
- Gjymnastikë sportive - Lëvizjet me trup të lirë: ekuilibri ballor, vertikalja mbi duar, kapërdimi para, rrotullimi anësor në të dy anët ose ylli (meshkujt dhe femrat).
- Not (demonstrim i një nga teknikat e notit)
- Agjilitet (T-testi)

Kriteret e poentimit, janë sipas Rregullores së Brendshme mbi kriteret e veçanta në disiplinat përkatëse.

Sportistët me rezultate të dalluara në sportet ndërkombëtare dhe ata në sportin Kosovar poentohen edhe me pikë bonus, sipas kriterëve të posaçme të Rregullores së Brendshme.

Kandidatët janë të obliguar që në ditën e provimit pranues të kenë pajisjet sportive.

XIII. FAKULTETI I EDUKIMIT- PRISHTINË

Në vitin e parë të studimeve do të regjistrojë **319** studentë të rregullt dhe atë në programet si në vijim:

Fakulteti-Departamenti-Programi	Per studime të rregullta	Per studime me korrespondencë	Familja e dëshmorëve 2%	Kandidatë nga komunitetet jo-shumicë 12%	Kandidatë nga Mali i Zi, Presheva, Bujanoci, Medvexha, 3%	Kandidatë nga Maqedonia dhe Shqipëria, 2%	Gjithsej
---------------------------------	--------------------------	-------------------------------	-----------------------------------	--	---	---	----------

Edukimit	270	0	5	30	9	5	319
Departamenti Fillor	120	0	2	14	4	2	142
Programi Fillor	120	0	2	14	4	2	142
Departamenti parashkollor	90	0	2	9	3	2	106
Programi Parashkollor	90	0	2	9	3	2	106
Departamenti i pedagogjise	60	0	1	7	2	1	71
Programi Pedagogji e Përgjithshme	60	0	1	7	2	1	71

PROVIMI PRANUES

- Programi Fillor: 1. Gjuhë dhe letërsi shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji;
- Programi Parashkollor: 1. Gjuhë dhe letërsi shqipe, 2. Matematikë, 3. Psikologji;
- Programi Pedagogji: 1. Gjuhë shqipe, 2. Psikologji, 3. Edukatë qytetare;

